

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional Musli Gashi, në kontestin juridik sipas padinë e paditësit Posta dhe Telekom i Kosoves – Vala 900 me seli në Prishtinë, kundër të paditurit R. G. nga Prizreni, Rr..., nr..., tani në adresë të panjohur, te cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme avokate B. B. nga Prizreni, për shkak të përmbushjes së kontratës, vlera e kontestit 3.133.13 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 12.12.2013 morri këtë

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses PTK – Posta dhe Telekom i Kosovës - Vala 900 me seli në Prishtinë, **si e bazuar**.

II. OBLIGOHET i padituri R. G. nga Prizreni Rr..., nr..., tani në adresë të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme avokate B. B. nga Prizreni, që në emër të përmbushjes së kontratës për shfrytëzimin e telefonit roming të paguajë shumën prej 3.004.75 €, me kamatë ligjore prej 3.5%, duke filluar prej datës e parashtrimit të padisë deri pagesën definitive, si dhe shpenzimeve procedurale shumën prej 25 €, në emër të taksës gjyqësore për padinë, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimin, nën kërcënim të ekzekutimet të dhunshëm.

A r s y e t i m

E autorizuar e paditësës gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi si në padinë të precizuara në procesverbal, duke kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe i padituri të obligohet që paditësës t'ia kompensojë borxhin në shumën prej 3.004.75 €, me kamatë ligjore pre 3.5 %, duke filluar prej datës e parashtrimit të padisë deri pagesën definitive, si dhe shpenzimeve procedurale shumën prej 25 €, në emër të taksës gjyqësore për padinë, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimin, nën kërcënim të ekzekutimet të dhunshëm.

Gjykata me aktvendimin C.nr.649/03 te datës 24.09.2013 te paditurit R. G. nga Prizreni, tani me adresë te panjohur i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm avokat B. B. nga Prizreni konformë nenit 79 par.3 pika nën a te LPK-së.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurit avokate B. B. sipas aktvendimit C.nr.649/03 te datës 29.09.2013, në përgjegjen në padi në tërësi e kundërshton padinë dhe kerkespadinë e paditësës kundër të paditurit si të pa bazurë sepse kerkesa e paditësës nuk ka mbeshtetje në asnjë punë juridike të lidhur me shkrim dhe me mirëbesim, me propozim që gjykata ta obligojë paditesin ta bëjë precizimin e padisë dhe ti bashkangjes provat, ose ta refuzon kërkesëpadinë si te tillë.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat ka bërë leximinin e kontratës së lidhur ndërmjet paditëses dhe te paditurit te datës 13.03.2001 me nr. 1082, konton me numrit 2010-4500 mbi gjendjen i datës 18.02.2002, historijatin mbi kontos për te paditurin te datës 11.09.2013.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të autorizuarit të paditësit dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se i padituri i ka borxh paditëses në shumën prej 3.004.75 €, në emër të shfrytëzimit të telefonit roming i cili borxh është konstatuar gjatë procedimit të kësaj çështje civile si dhe nga shqyrtimet kryesore si dhe nga informata e e llogarisë së e përpiluarë nga paditesja e datës 19.11.2013, e cila gjendet në shkresat e lëndës, me anë të së cilave gjykata ka vërtetuar se i padituri ka bërë shfrytëzimin e telefonisë romingë nga ana e paditëses, andaj gjendja ekzistuese reale tregon për ekzistimin e borxhit nga ana e të padituritë.

Me nenin 17 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – Nr. 690, është paraparë se **“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”**, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se **“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**.

Gjykata nuk ka bërë vlerësimin e provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, pasi vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.649/03 me datë 12.12.2013

Bashkëpunëtor profesionalë
Musli Gashi

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.